



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.96/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vodusur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së banerit të kandidates për anëtarë të kuvendit komunal në Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1,400.00 (njëmij e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcenim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 29.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 29.09.2017 në rrugën Dëshmorët e Kombit afér xhamis së madhe dhe kishës ortodokse në Ferizaj mbi rrugë publike është vendosur baneri i kandidates për kuvendin komunal nga subjekti politik LDK.

Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b0 të LZP-së dhe Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe 3.4 të Rregullës 13/2014.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografë të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se ka kërkuar nga kandidatja në fjalë dhe shtabi lokal ne Ferizaj që të evitoj shkeljen.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografët me të cilat shihet se është larguar baneri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidates për anëtarë të kuvendit komunal nga ky subjekt politik LDK është vendosur mbi rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila

përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneri reklamues i kandidates për anëtare të kuvendit komunal nga subjekti politik në fjalë, është vendosur mbi rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik LDK në përgjigjen në ankes të datës 02.10.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri reklamues i kandidates nga subjekti politik LDK është vendosur mbi rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë larguar banerin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**  
ZL. Anr.96/2017 më datën 03.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.